

**2 Flokteri: Bisedimet për KKP-në e zejes Unia angazhohet për paga më të mira!**

**3 Konferenca e Komisionit Federal për Migracion Sigruria sociale në shoqërinë zvicerane të migracionit**

**4 «Diaspora Flet» 2023 GERMIN synon të lidh mërgatën me vendet amë**

Nr. 3 | Maj 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Zbritje e madhe për të ardhurat e ulëta dhe të mesme

## Përse ne e luftojmë BVG/LPP 21



Jo shkurtimeve të pensioneve profesionale BVG/LPP. Nuk është e drejtë të paguajmë më shumë e të marrim më pak!

Në mesin e marsit e djathta shumicë në parlamentin zviceran ka vendosur për një reformë të papranueshme mbi shtyllën e dytë të sigurimeve shoqërore. Reforma e pensioneve profesionale të pleqërisë BVG/LPP 21 nuk bie përmirësime për pensionet e grave dhe për të ardhurat e ulëta, porse një zbritje të madhe të pensioneve.

Brigitta Bernet, eksperte në politikat themelore

Bota i ka drejtuar sytë me tmerr nga Franca – ku përsëri janë duke u zhvilluar protesta masive. Shkollat, universiteti dhe qarkullimi i trenave janë paralizuar nga grevat. Arsye për këtë është reforma e pensioneve. Sikur vendi fqinjë ashtu edhe Zvicra ka vështirësi me reformën e përkujdesjes në pleqëri. Frontet dhe bllokadat janë të ngjashme dhe të krahasueshme në të dy vendet. Edhe pse në Zvicër nuk ka demonstrata masive dhe nuk po digjen ndërtesat e kuvendeve, megjithatë po zhvillohen debate parlamentare të urryera dhe beteja votimi. Por edhe këtu rrezikohet po aq sa në Francë. Tek Reforma e aprovuar e shtyllës së dytë BVG/LPP 21 nuk bëhet fjalë vetëm për çështje teknike në lidhje me normën e konvertimitit «të duhur» në funksion të rritjes së jetëgjatësisë. Edhe më shumë kemi të bëjmë me çështje themelore të përkujdesjes, që ne duhet të kemi për njeri tjetrin. Pasi që pensioni i pleqërisë është e arritur shoqërore nga më të rëndësishmet nga të gjitha tjerat. Vështirë se ndonjë gjë është aq e rëndësishme sa jeta me dinjitet në pleqëri. Siç tregojnë vendimet e reja të parlamentit, si duket nuk ka më vullneti politik për tu përballuar tek kjo sfidë me solidaritet dhe drejtësi.

Në vend të kësaj, qëllimi i reformës së shtyllën e dytë të pensionit BVG/LPP 21 është të «ristrukturojë» atë,

duke përqesuar gjendjen e pensionistëve. Komponenti më përcaktues i reformës BVG/LPP 21 është ulja e normës minimale të konvertimitit në pjesën e detyrueshme nga ajo aktuale 6.8 në 6%. Norma e konvertimitit është faktori që kapitalin e akumuluar e përllogarit në një pension të përjetshëm. Ulja e tij nga 6.8 në 6% do të thotë se për çdo 100000 CHF të kursyera në kapitalin e pleqërisë, në të ardhmen do të paguhen vetëm 6000 CHF pension në vit në vend të 6800 CHF aktuale. Kjo do të thotë konkretisht: një ulje drastike e pensioneve prej 12 përqind! Për një murator me një pagë mujore prej 6700 CHF, i cili për 40 vite pune ka kursyer një kapital pleqërie prej 360000 CHF, reforma qon në një ulje mujore pensioni prej 240 CHF. Nëse muratori në fjalë pensionohet sot, ai nga shtylla e dytë e arkës të pensioneve BVG/LPP do të merr një pension prej 2040 CHF. Nëse ai pensionohet nesër – pas hyrjes në fuqi të reformës BVG/LPP 21 –, atëherë ai do të marrë vetëm 1800 CHF në muaj. Nuk ka asnjë dëmshpërblim tjetër për të.

Çka është e vërteta BVG/LPP 21 ofron masa balancimi për të ardhura shumë të ulëta. Por, këto janë krejtësisht të pamjaftueshme. Vetëm ata që marrin një pension nga AP (Arka e pensioneve profesiona-

le) që është më e ulët se 1000 CHF në muaj kanë të drejtë për kompensim të plotë; së dyti, kush i përket të ashtuquajturës gjeneratë kalimtare (lindur mes viteve 1958 dhe 1973); së treti, që ka paguar në një fond pensioni për të paktën 15 vjet pa ndërprerje dhe, së katërti, që tërheq të paktën gjysmën e mjeteve të kapitalit të grumbulluar të pleqërisë si pension. Për shkak të gjitha këtyre kufizimeve, më së shumti një e katërta e të prekurve do të merrte kompensim të plotë nga «gjenerata kalimtare». Më shumë se gjysma e pensionistëve të gjeneratës kalimtare nuk do të merrnin asgjë. Dhe të gjithë ata që janë më të ri se të lindurit në vitin 1973 nuk do të marrin asnjë dëmshpërblim. Pikërisht kjo është tejet e dobët. Qysh tani pensionet janë trupërisht të ulëta për pagat e ulëta dhe të mesme. Është e papranueshme që ato në planin afatgjatë të bëhen edhe më të ulëta.

**Edhe pse të gjithë punonjësit duhet të paguajnë më shumë në fondin e pensioneve, pensionet do të bien! Unia është duke e luftuar propozim ligjin e shkurtimeve të pensioneve BVG/LPP 21 dhe me 31 mars 2023 ka iniciuar referendumin.**

### Editorial



#### Paguaj më shumë, merr më pak!

Në vend se të sigurohen pensionet dhe të përmirësohet gjendja e të ardhurave të ulëta në shtyllën e dytë të arkës së pensioneve, reforma BVG/LPP 21 qon në një ulje të madhe pensionesh deri në 3240 CHF në vit, gjegjësisht 271 CHF në muaj. Edhe pse të gjithë punonjësit paguajnë më shumë në AP (Arkën e Pensioneve Profesionale), pensionet do të zvogëlohen.

Pikërisht të punësuarit me të ardhura të ulëta duhet të paguajnë shumë më shumë. Kushdo që paguan më shumë kontribute në AP nga paga, do të ketë gjatë jetës së punës më pak para në dispozicion – pse? Që në fund të fundit, në shumicën e rasteve, të marrë edhe një pension më të ulët.

Sidomos për ne gratë, propozimi ligjor është një farsë. Kujtojmë vjeshtën e vitit 2022 dhe të gjitha premtimet e bëra të së djathtës në votimin e AHV/AVS 21. Ata na thanë: Nëse gratë punojnë një vit më shumë, ne do të përmirësojmë gjendjen e tyre të mjerueshme të pensioneve me reformën e shtyllës së dytë të pensioneve. Por kjo nuk është e vërteta. Në vend që të përmbushte premtimin, e djathta shumicë në parlament miratoi një reformë që po çon në humbje masive pensionesh. Përsëri, gratë ngushellohen për disa dekada – dhe edhe më tej duhet vazhdojnë të kenë pensione trupërisht të ulëta.

Pala e treta që i gëzohet kësaj reforme është industria financiare, e cila përveçson çdo vit miliarda franga zvicerane nga kursimet tona. Rritja e kontributeve dhe ulja e pensioneve rritë fitimet e bankave dhe sigurimeve. Kjo reformë ka marrë një drejtim krejtësisht të gabuar. Shtylla e dytë duhet të ofrojë siguri shoqërore. Jo të shndërrohet në dyqan vetëshërbimi për kapitalin financiar! Jo me ne!

Brigitta Bernet



## News

## Shpëtimi i Credit Suisse: Vetëm për Bankat ka gjithmonë para

Kur bëhet fjalë për interesat e të varurve nga pagat dhe të pensionistëve, e djathta borgjeze nuk donë të ketë para. Por, megjithatë, për bankat, ofrojnë miliarda brenda një periudhe të shkurtër kohore. Nga ana tjetër, është shumica parlamentare e së djathtës borgjeze që vendos të rishikojë shtyllën e dytë të pensioneve BVG/LPP me qëllim uljen e pensioneve dhe në të njëjtën kohë të rrisin zbritjet e pagave. Kemi një Qeveri Federale të dominuar nga e djathta borgjeze që dëshiron të kursejë në shtyllën e parë të pensioneve AHV/AVS. Kemi një bllok të së djathtës në parlament që me një buzëqeshje arrogante dhe të lodhur heq mënjanë të gjitha masat e qeverisë për të luftuar inflacionin, si p.sh. rregullimi i çmimeve të energjisë dhe qirave ose ulja e primeve të sigurimit shëndetësor për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

## Më në fund fitore! Më në fund më shumë pagë!

Të 20 punonjësit e ndërmarrjes logjistike festojnë dhe përqafohen: pas 1345 ditësh përfundon më në fund greva më e gjatë në Evropë! Jelekët e sigurisë të punëtorëve të Novaltia shpërthejnë në ajër në momentin kur shpallen rezultatet e negociatave në selinë e sindikatës së Solidaritetit të Punëtorëve Baskë (ELA) në Bilbao në fund të marsit. Punëtorët e furnizuesit të farmacisë Novaltia dolën në grevë për saktësisht tre vjet e tetë muaj. Tani kjo po u paguhet: me 9500 euro dëmshpërblim, rritje pagash plus 60 ditë pushimi. Për grevistët ishte gjithashtu e rëndësishme që kompania të paguante një euro simbolike në arkën e grevës ELA për çdo ditë të grevës. Pa to, greva e gjatë do të ishte e pamundur, pajtohen njëzëri punëtorët.

## Transporti rrugor: Drejtuesit e kamionëve në grevë spontane

Shfrytëzimi nëpër rrugët e Evropës është përditshmëri. Por tani kamionistët po mbrohen. Më shumë se 60 shoferë nga një kompani polake refuzojnë të vazhdojnë të ngasin kamionët më tej. Ata presin në një ndalesë pushimi pranë qytetit gjerman Darmstadt - derisa të paguhet pagat e tyre. Sepse pa para familjet e tyre mbeten duarthatë. Drejtuesit e kamionëve mbështeten nga aktivistët të sindikatës holandeze FNV dhe rrjetit këshillues «Faire Mobility» të Bashkimit të Sindikatave Gjermane (DGB). Edhe mbështetja e publikut është e madhe. Sindikalistët nga rajoni shkojnë çdo ditë aty dhe me veti sjellin artikuj ushqimor.

## Paga minimale: Bëhen përparimet

Pesë Kantone; Cyrihu, Bazel-Qytet, Gjenera, Neuenburg, Jura und Tiçino, tanimë e kanë pagën minimale, ndërsa në gjashtë tjerë është duke vazhduar grumbullimi i nënshkrimeve. Në janar, Unia në Baselland dhe një aleancë (përfshirë Unia) në Valis nisën nga një iniciativë popullore për pagën minimale. Edhe në Zvicrën Lindore, sindikatat gjithashtu kanë nisur peticion për një pagë minimale për St. Gallen, Thurgau dhe të dy Appenzell-ët. Aktualisht po mbledhen nënshkrime në të gjashtë kantonet.

## Bisedimet për pagën e fabrikës Toblerone

Në bisedimet e pagave për punonjësit e fabrikës Toblerone në Bern-Brünnen, kompania Mondelez shërbehet me provokime maksimale: kompania ka njoftuar se nuk dëshiron më të negociojë me punëtorët. Në vend të kësaj, kompania që posedon me miliarda euro dëshiron të imponojë në mënyrë të njëanshme një ulje të pagave reale. Punonjësit dhe sindikata Unia nuk e pranojnë këtë. Bisedimet janë duke u zhvilluar për rreth 200 punonjës të fabrikës Toblerone në Bern-Brünnen. Në kushtet e inflacionit të lartë dhe rritjes drastike të primeve të sigurimeve shëndetësore, si dhe barrës shtesë të kalimit në sistemin me kartë turne, punonjësit kërkojnë një rritje të përgjithshme të pagave prej 6 përqind, por kompania kundërshtoi negociatat. Kompania në vitin 2022 shënoi të ardhura neto prej 2.7 miliardë dollarë, ndërsa aksionarëve iu paguan 4 miliardë dollarë

## Zeja e floktarisë: Bisedimet për KKP

## Unia lufton për paga më të mira

Kontrata Kolektive e Punës për sektorin e floktarisë skadon në fund të vitit dhe duhet të ri-negociohet. Bisedimet për KKP janë ndërprerë, pasi shoqata e punëdhënësve «Coiffure Suisse» ka bërë një propozim të papranueshëm dhe është duke mbajtur qëndrim kryeneç.

Montaña Burdalo Martin

Pagat në sektorin e floktarisë janë tejet të ulëta. Paga minimale për një zanatli në aftësim e sipër profesional është aktualisht në mesataren zvicerane tek 3850 CHF bruto, ndërsa për një fillestar në profesion vetëm tek 3450 CHF. E gjithë kjo tek një orar javor pune prej 43 orëve. Pa të drejtën në pagën e 13 mujore. Në kantonet me pagë minimale ligjore vlejnë pagat minimale kantonale, në rast se ato janë më të larta se sa me KKP. Një floktar i pakualifikuar gjenevas përfiton nga paga minimale ligjore prej 24 CHF në orë, që është larg nga paga më e ultë minimale bazuar në KKP prej 3470 CHF – që i bie 18.75 CHF në orë. Mirëpo kjo së shpejti mund të ndryshojë: Parlamenti në dhjetor ka aprovuar mocionin e senatorit liberal Erich Ettin, i cili aktivisht mbështet punëdhënësit «Coiffure Suisse». Nëse ky mocion zbatohet, atëherë në të ardhmen në çdo rast do të vlejnjë pagat e përcaktuara minimale me vlefshmëri të detyrueshme, edhe nëse ato do të ishin më të ulëta se sa paga minimale kantonale. Kjo për shumë të pakualifikuar nga sektori i floktarisë në kantonet e prekura do të qonte tek një shkurtim masiv pagash!

## Propozim i papranueshëm i punëdhënësit Coiffure Suisse

Shoqata e punëdhënësve Coiffure Suisse ka mbështetur aktivisht jo vetëm mocionin Ettin, porse ka bërë edhe një propozim të



Kushtet e punës dhe pagat në floktari duhet përmirësuar!

si person i pakualifikuar» raporton Igor Zoric, anëtarë i drejtorisë qendrore të sektorit të shërbimeve në Unia dhe përgjegjës për sektorin e floktarisë. «Përveç kësaj, propozimi i shoqatës së punëdhënësve është i papërshtatshëm për të mundësuar zbatimin dukshëm më të mirë të KKP dhe për të mundësuar ndërmarrjen e veprimeve më efikase kundër dumpingut.», sqaron më tej sindikalisti dhe shton më tej: «Një propozim i tillë është i papranueshëm, ndaj negociatat janë pezulluar.»

Unia dëshiron një KKP, e cila vlerëson profesionin dhe lufton dumpingun. Ajo i ka kërkuar shoqatës së punëdhënësve Coiffure Suisse të kthehet në tryezen e bisedimeve. Deri më tani shoqata nuk është përgjigjur.

## Vendimi i Gjykatës Federale për Uber

## Gjykata Federale sqaron përfundimisht rolin e punëdhënësit

Sikur edhe pritej, Gjykata Federale ka vërtetuar se shoferët e kompanisë së takside Uber janë të punësuar, pra nuk janë të vetëpunësuar. Prandaj, Uber duhet të respektojë të gjitha detyrimet e punëdhënësit në lidhje me sigurimet shoqërore – edhe në mënyrë retrospektive.

Darinka Filipovic

Gjykata federale i mbetet besnike linjës së saj. Pasi që më 30 maj 2022 pati vendosi se sipas ligjit të punës Uber është punëdhënësi i shoferëve të saj, tani më në fund ka përcaktuar që shoferët janë të punësuar edhe sipas ligjit të sigurimeve shoqërore. Uber duhet të regjistrojë punonjësit e saj në sigurimet shoqërore dhe të paguajë kontributet përkatëse të punëdhënësit.

## Edhe pagat duhet të paguhet në mënyrë retrospektive

Kompanitë e sigurimeve shoqërore duhet të mbledhin në mënyrë retrospektive kontributet e sigurimeve shoqërore nga Uber. Si bazë për këtë duhet të vlejnjë pagat minimale që sigurojnë jetesën. Uber duhet t'i paguajë shoferëve të saj në mënyrë retrospektive të gjitha kërkesat e tjera (pagat, rimbursimet e shpenzimeve, të drejtat për pushime). Sipas vlerësimeve të Unia, Uber i detyrohet shoferëve të saj disa qindra milionë franga. Është e paimagjinueshme që mijëra shoferë individualisht duhet të ngisnin padi për të realizuar të drejtat e tyre, ngase punëdhënësi i tyre thjesht refuzon të përmbushë detyrimet e tija ligjore. Në vend të

kësaj, nevojitet një zgjidhje kolektive në të gjithë Zvicrën në mënyrë që shoferët të marrin paratë që u takojnë.

## Duhet ndaluar Uber derisa të respektohen ligjet

Përveç kësaj, autoritetet duhet të ndalojnë menjëherë aktivitetet e Uber derisa kompania të veprojë në përputhje me ligjin. Domethënë, derisa çdo shofer të ketë një kontratë pune, pagat dhe shpenzimet rregullohen në përputhje me ligjin dhe të

gjithë shoferët të jenë regjistruar në sigurimet shoqërore.

## Tek personeli i huazuar, zbatohen ligji i ndërmjetësimi të punës dhe KKP

Uber tani ka filluar të punësojë shoferë përmes ndërmarrjeve të treta. Është e qartë se bëhet fjalë për personel të huazuar. Politikanët dhe autoritetet duhet të kujdesen që ligjet dhe KKP-ja përgjithësisht detyruese të zbatohen.



Për vite të tëra, shoferët e Uber kanë luftuar për të drejtat e tyre dhe kundër konkurrencës së pandershme nga Uber.



Vendimi mbi tregtinë me njerëz në ndërtimtari

## 10 vjet burg për punëdhënësin kriminel

Askush nuk ishte më i lirë se kjo kompani e madhe ndërtimi zvicerane. Pothuajse të gjithë tenderët e mëdha fitimprurëse iu dhanë asaj.

Marie Saulnier Bloch

Ajo fitoj miliona, shpesh si nënkontraktorë. Nga viti 2012 deri më 2017 ndërmarrja e ndërtimit cyti më shumë se 100 suvatues nga Hungaria, Moldavia dhe Rumania me premtime të rreme në Zvicër. Ndërsa vet punëdhënësi udhëtonte me avion privat dhe automobil Ferrari, punëtorët përballshin me kushte çnjerëzore të punës, dhunë, kërcënime me vdekje, paga për orë nga 4 deri në 9 CHF, një pjesë e rrogës që duhej ti kthehej punëdhënësit me para në dorë, kushte banimi pa dinjitet etj.

### Drejtësia zvicerane nëse donë mund edhe të veproi

Prokurori publik kishte kërkuar dënim me burg prej 8 vjet e 4 muaj – për trafikim me genie njerëzore, fajde profesionale dhe 14 krime të tjera. Avokati mbrojtës, i cili kërkoi pafajësi për shumicën e akuzave, foli për një skandal gjyqësor të panevojshëm. Por gjykata vendosi: 10 vite burg dhe konfiskim pasurie për njeriun që shfrytëzonte punonjësit e tij dhe nuk paguante asnjë cent tatim autoriteteve dhe as në sigurimet shoqërore.

Punëdhënësi ka mbetur i fshehur (meqë ra fjala, ai nuk ishte i pranishëm as në gjyqin kundër tij) dhe ndoshta edhe do ta apelojë vendimin. Por mesazhi i dënimit të tij është i qartë: pas një vendimi të parë të vitit 2020 në Gjenevë, në të cilin një tjetër ndërtues ishte dënuar me 6 vjet, gjykatësit në Cyrih bëjnë të qartë se punëdhënësit nuk mund të bëjnë më çka duan dhe si tu teket atyre, nëse autoritetet angazhohen në luftën kundër shfrytëzimit të fuqisë punëtore.



Tregtimi me njerëz në ndërtimtari dhe shfrytëzimi i tyre çnjerëzor duhet të luftohet deri ne çrrënjosjel

## Konferenca e Komisionit Federal për Migracion

# Siguria sociale në shoqërinë zvicerane të migracionit

Kushdo që në Zvicër ndodhet në situatë nevojë duhet të përkujdeset nga një rrjet i fondeve të mbështetjes sociale. Këto rrjeta nuk janë të njëjta për të gjithë. Pse janë këto dallime? Cilat janë pasojat për të prekurit dhe për shoqërinë zvicerane të migracionit?

Një raport nga terreni, nga Marilia Mendes, Marie Saulnier Bloch, Hilmi Gashi

Ministrja Baume-Schneider në fjalën e hapjes vuri në dukje disa nga sfidat e politikës së migracionit. Ajo ndër të tjera përmendi nismën parlamentare të Samira Martit «Varfëria nuk është krim». Çështja e ndihmës sociale u shqyrtua më pas nga një këndvështrim shkencor. Eva Maria Belser, profesore në Universitetin e Freiburg-ut, tregoi «rrjetet e ndryshme të ndihmës sociale» dhe mbështetjen që njerëzit në Zvicër gjejnë varësisht nga statusi i tyre. Ajo nivelin e ulët të përfitimeve për grupe të caktuara njerëzish dhe kategorizimin joproporcional e përshkroi si «problematik nga pikëpamja kushtetuese». Dominik Hangartner, profesor në shkollën e lartë politike RETH Cyrih, përmes hulumtimit të tij mundi të tregoi se me çdo frang mbështetje shtesë, mund të arrihej një shumëfish i integritimit dhe performancës ekonomike. Prof Dr. Jean-Pierre Tabin, në shkollën e lartë sociale në Lozanë nënvizoi se migrantët kontribuojnë financiarisht në sistemet e sigurimeve shoqërore dhe megjithatë përballen me diskriminim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në qasje. Është e nevojshme një

«qasje në shërbimet komunale pa frikë» dhe një «politikë sociale mbështetëse» pa raportuar në policinë e migracionit.

### Mbresëlënëse, por

Analizat shkencore dhe shembujt praktik ishin të një standardi të lartë. Gjithsesi. Edhe në konferencën e këtij viti përsëri mungonin migrantët si aktorë veprues. Mungonte edhe ana e ekonomisë. Për shembull, do të ishte shumë interesante të kuptohej se si e shohin punëdhënësit problemin e «të varfërve që punojnë» dhe çfarë zgjidhjesh propozojnë ata në mënyrë që njerëzit të mund të jetojnë nga pagat e mjaftueshëm për punën e tyre dhe që të mos kenë nevojë të përfundojnë në asistencë sociale. Kërkesat politike në lidhje me tejkalinim e varfërisë dhe qasjen jo diskriminuese në asistencë sociale për migrantët gjithashtu nuk u diskutuan në thellësi. Ajo që mbetet është një diskutim teorik me qëllime të mira, por pa kërkesa konkrete dhe praktike.

## Intervista



Helin Genis është e lindur në Bernë dhe angazhohet për barazi krah për krah me të ëmën. Hülya është aktive tek grupi i grave. Helin thotë se ajo trashëgoi ndjenjën e drejtësisë sociale të nënës së saj. Nënë e bijë janë duke u mobilizuar për një grevën e madhe feministe 2023.

### Hülya, ti donë t'ia kalosh më tej vajzës tënde luftën për drejtësi sociale e barazi, pse?

Gratë kanë luftuar kundër pabarazisë për shekuj. Ato kanë fituar shumë të drejta përmes betejave të palodhura dhe të pafundme: e drejta e votës dhe më shumë pushim lehonie janë disa prej tyre. Ndihej përgjegjës për të luftuar për të drejtat e mia dhe të brezit të ardhshëm, sikur është vajza ime. Kështu që ne si gra, si migrante, të trajtohemi në mënyrë të barabartë dhe të drejtë. Askush nuk do të na e servojë të drejtat tona në pjatë. Prandaj për mua është e rëndësishme që të gjithë së bashku krah për krah më 14 qershor, të bëhemi pjesë e grevës dhe të dalim në rrugë.

### Helin, ti thua se ke trashëguar ndjenjën e drejtësisë sociale të nënës. Çfarë do të thotë kjo për ty?

Drejtësia sociale për mua do të thotë që të gjithë kemi të njëjtat të drejta, pavarësisht religjionit, ngjyrës, gjuhës, statusit të vendbanimit, vendit të origjinës, orientimit seksual etj. Për shembull, të gjithë duhet të marrin të njëjtat paga për të njëjtën punë. Askush nuk duhet të vdesë nga uria ndërsa të tjerët kanë shumë. Duhet të shpërndahet në mënyrë korrekte, të drejtë, të barabartë.

### E në lidhje me te drejtat e grave, migrantëve...

Shqetësimet e grave, migrantëve, njerëzve trans, të gjithë njerëzve të shtypur janë lënë pas dore. Ato nuk dëgjohen. Kjo shihet fare mirë, ku gratë vështirë se mund të bëjnë karrierë dhe fitojnë pak. Gratë duhet të zgjedhin mes karrierës dhe familjes. Ato shpesh punojnë në kushte të pasigurta dhe fitojnë më pak para, ndërsa në të njëjtën kohë duhet të kujdesen edhe për fëmijët dhe familjet e tyre. Puna e kujdesit është gjithashtu punë që duhet paguar. Detyrat në shtëpi gjithashtu duhet të ndahen në mënyrë të drejtë.

### Ti thua se nëna jote të tregoi se si një person duhet të mbrojtë të drejtat e tija, apo jo?

Nëna ime është një shembull model për mua. Ajo ishte e drejtë me të gjithë! Pa marrë parasysh se kush, çfarë dhe si. Ajo i trajton të gjithë në mënyrë të barabartë. Njeriu mund të mendojë se këto janë gjëra të vogla në jetën e përditshme, por për mua ishte shumë domethënëse, mbresëlënëse, e jashtëzakonshme. Kjo përcakton edhe personalitetin tim. Nëna ime gjithashtu më tregoi se është e rëndësishme të angazhohesh për njerëzit që mund të mos jenë mjaftueshëm të fortë. Si fëmijë, kam vënë re gjithashtu trajtimin e pabarabartë dhe kam qëndruar në mbrojtje të fëmijëve të tjerë që nuk trajtoheshin në mënyrë të drejtë.

### Si do të doje ti të ndash më tej përvojat tua?

Ashtu si nëna ime, unë dua të vazhdoj të luftoj për të drejtat e grave, për barazi, kundër racizmit dhe diskriminimit. Ne tashmë deri më sot kemi arritur shumë, sepse njerëzit kanë dalë në rrugë dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë. Ne duhet të mbrojmë të drejtat tona dhe t'i kërkojmë ato. Barazia duhet të ecë përpara. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të marrim pjesë në grevën feministe më 14 qershor. Bëhet fjalë për të ardhmen tonë. Së bashku jemi të fortë.

Hülya: Greva është e drejta jonë themelore dhe mjet për të realizuar kërkesat tona. Dhe forcon solidaritetin midis punëtorëve dhe ka funksion edukativ. Greva sjell në skenë akumulimin historik të betejave të mëparshme, së bashku me lëvizjen e grave, luftërat për të drejtat e njeriut dhe lëvizjen e të papunëve, dhe i lidh ato së bashku në mënyrë të reja. Seksizmi, dominimi mashkullor, racizmi, anti-migrantizmi, raca, religjioni. orientimi antiseksual, dhuna seksuale po rriten. Të gjitha këto janë arsye të rëndësishme që ne të bëjmë grevë. U bëjmë thirrje të gjitha grave të dalin në rrugë më 14 qershor për të kërkuar të drejtat e tyre.

Emine Sariaslan



## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Pensioni i veçorisë dhe ai i invaliditetit IV/AI: A i marr unë të dy pensionet?

Unë marr një pension veçorie dhe për shkaqe shëndetësore me është dashur të lajmërohem tek sigurimi i invaliditetit. Nisur nga supozimi se më pas do të më jepet një pension IV nga sigurimi i invaliditetit: a marr atëherë edhe pensionin e veçorisë edhe atë të IV?

**Myriam Muff:** Jo. E drejta e pensionit të veçorisë edhe pse shuhet bazuar në ligjin federal të pensionit të pleqërisë dhe trashëgimisë (AHVG/LAVS) në parim vetëm nëse personi i veçj martohet përsëri ose nëse vdes. Megjithatë, nëse merr pensionin e veçorisë dhe një pension invaliditeti në të njëjtën kohë, paguhet vetëm pensioni më i lartë. Këtë e rregullon kështu ligji (AHVG/ LAVS, neni 24 b).

Pra, nëse ju jepet një pension invaliditetit IV/AI, do të kontrollohet se sa i lartë është ai. Nëse pensioni IV/AI është më i lartë se ai i veçorisë, tani e tutje do të merrni vetëm pensionin IV/AI. Ose anasjelltas, do të merrni pensionin e veçorisë nëse ai është më i lartë se ai i IV/AI.

(Work, 14.4.23)

### Arka e pensionit: Çka, nëse mungon certifikata e pensionit?



TE KURSËRIT PËR PLEQËRI: Punëdhënësit duhet të informojnë punëmarrësit mbi sigurimin e tyre pensional profesional BVG/LPP. (Foto: Manuela Jans/ neue LZ)

Kam tre vjet që punoj me kohë të plotë si nëpunëse dhe nuk kam marrë certifikatë pensioni nga fondi pensional. Prandaj jam e shqetësuar nëse jam e siguruar në një fond pensional dhe ku janë mjetet e mia të pensionit nga shtylla e dytë e pensionit. Çfarë mund të bëj?

**Gilles Sciboz:** Punëdhënësi është përgjegjës për sigurimin e BVG/LPP të punonjësve të tij. Ai duhet të bëhet pjesë në një fond pensioni dhe të sigurojë punonjësit e tij atje. Punëdhënësi juaj ju informon për pensionet profesionale. Nëse nuk merrni asnjë informacion nga shefi juaj, mund të kontaktoni zyrën përgjegjëse të kompensimit të AHV/AVS. Kontaktet mund t'i gjeni në faqen e internetit të qendrës së informacionit AHV/IV/AVS/AI (rebrand.ly/vergleichskasse). Fondi i kompensimit AHV/AVS është përgjegjës për të kontrolluar nëse dhe me cilin fond pensioni është anëtarësuar punëdhënësi juaj. Pastaj kontaktoni fondin përgjegjës të pensionit për të kërkuar certifikatën e pensionit të dëshiruar me informacionin mbi mjetet tuaja të kursyera të pensionit.

(Work, 31.3.23)

### Papunësia: Cila është periudha e ankesës për sanksionet?

Unë jam i papunë dhe kam marrë një vendim sanksioni me arsyetimin se nuk kam bërë përpjekje të mjaftueshme për të punuar. Unë nuk jam dakord me këtë dhe doja të apeloja kundër vendimit. Fatkeqësisht, periudha prej 30 ditësh për ankesë tashmë ka skaduar. A ka ndonjë gjë tjetër që mund të bëj?

**Nicole Debrunner:** Jo. Kushdo që nuk pajtohet me një vendim ka 30 ditë afat për ta kundërshtuar atë. Gjatë Krishtlindjeve, Pashkëve dhe verës vlen afat-pushimi. Datat e sakta janë dhënë në udhëzimet mbi rregullat juridike që i bashkëngjiten vendimit për sanksione. Dita pas marrjes së porosisë është dita e parë e kësaj periudhe. Nuk mund të zgjatet pasi është një periudhë ligjore. Prandaj, Zyra regjionale për ndërmjetësimin e punës (RAV/ORP) ose Arka e sigurimit të papunësisë nuk lejohet të veprojë për kundërshtimet e vonuara. Vendimi, që ju besoni se është i pasaktë, tani është ligjorë dhe i detyrueshëm dhe i zbatueshëm. Ju mund të paraqisni vetëm një kërkesë për rishqyrtim.

Zyra regjionale për ndërmjetësimin e punës (RAV/ORP) ose Arka e sigurimit të papunësisë mund t'u rikthehet vendimeve ligjorë të detyrueshme ose vendimeve të kundërshtimit nëse ato janë padyshim të pasakta dhe korrigjimi i tyre është i një rëndësie të konsiderueshme. Megjithatë, është tërësisht në gjykimin e Arkës nëse do ta pranojë kërkesën apo jo. Nuk ka asnjë të drejtë ligjore për këtë, as nuk ka ankim kundër një vendimi mospranimi për rishqyrtim. Vetëm nëse autoriteti administrativ lëshues merret me përmbajtjen e kërkesës për rishqyrtim, mund t'i drejtoheni gjykatës kundër një vendimi negativ. Prandaj është shumë e rëndësishme, kur merrni njoftime zyrtare, të kontrolloni menjëherë se sa kohë ju duhet ta bëni këtë nëse nuk pajtoheni me vendimin, për të ndërmarr veprime ligjore.

(Work, 3.3.23, e adaptuar)

(Work, 17.3.23)



## Parlamenti Evropian miraton liberalizimin e vizave për Kosovën

# Lëvizja e lirë nga 1 janari i vitit 2024

Në Bruksel me 20 prill 2023 u nënshkrua zyrtarisht në mjediset e Parlamentit Evropian akti ligjor për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Osman Osmani

Ky është dhe fundi i procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën. Më së voni nga një janari i vitit 2024 qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza deri në 90 ditë, brenda gjashtë muajsh, në cilindo nga shtetet anëtare të zonës Shengen. Nënshkrimi zyrtar u bë pas votimit me shumicë votash në Parlamentin Evropian, që shënon edhe hapin e fundit para botimit të vendimit në gazetën zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kosova ishte dhe vazhdon të jetë edhe për disa muaj, vendi i vetëm në Evropë, qytetarët e të cilit nuk kanë mundur të lëvizin të lirë në zonën Shengen. Hilmi Gashi, përgjegjës për grupet e interesit në Unia i gëzohet këtij vendimi: «Më në fund qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza në hapësirën e Shengenit. Një hap i vonuar, por më mirë vonë se kurrë. Më në fund qytetarët e Kosovës dalin nga izolimi i gjatë prej disa dekadash dhe mund të udhëtojnë lirshëm nëpër Kontinentin, pjesë e të cilit janë si në aspektin gjeografik, historik ashtu edhe në atë kulturor.»

Heqja e vizave jo vetëm se lehtëson udhëtimin e personave për vizita familjarëve të shumtë në Evropë, ajo gjithashtu është një shans i madh si për rininë Kosovare, ashtu edhe për profesionist të ndryshëm për të marrë pjesë në shkëmbime me bashkëmoshtarë dhe homolog të profesioneve në nivele të ndryshme.

Heqja e vizave mënjanon edhe pritjet e gjata përpara ambasadave, shpenzimet e larta financiare dhe mënjanon burokracinë.

### Përjashtimet

Liberalizimi i vizave që u miratua për Kosovën, vlen vetëm për bartësit e pasaportës së Kosovës, por jo edhe për ata shtetas të Kosovës që kanë pasaporta të lëshuara nga autoritetet serbe, kanë konfirmuar zyrtarë të Komisionit Evropian.

Ndërsa, as pas liberalizimit, shtetasit e Kosovës nuk do të mund të udhëtojnë pa viza në Spanjë.

## Konferenca «Diaspora Flet» 2023

# Lidhja e mërgatës me vendet amë

GERMIN organizon edicionin e tretë të konferencës më të madhe të diasporës shqiptare – «Diaspora Flet» në Prishtinë, Kosovë, më 18, 19 dhe 20 maj. Nën temën e përgjithshme «Si mund të bashkë-krijojmë» synojmë të diskutojmë dhe nxisim mënyrat e bashkë-krijimit, për përmirësim dhe zhvillimin e vendeve amë.

Osman Osmani

Pas organizimit tejet të suksesshëm të dy edicioneve në vitin 2018 dhe 2020, këtë vit konferenca do të mbledhë bashkë qindra profesionistë, politikëbërës dhe hisedarë nga diaspora dhe nga vendet amë, për të folur, prezantuar, dhe shkëmbyer informata, përvoja dhe ide në funksion të bashkë-krijimit të një të ardhme të mirë për shtetet tona.

### Objektivat e Konferencës «Diaspora Flet» janë:

1. Rritja e dialogut ndërmjet pjesëtarëve të diasporës dhe politikëbërësve, sektorit privat dhe shoqërisë civile nga vendet amë lidhur me temat dhe prioritetet e përbashkëta;
2. Të frymëzojë veprime të cilat do të krijojnë programe dhe politika specifike; Nxitja e bashkë-krijimit dhe bashkëpunimit ndërmjet individëve dhe subjekteve të ndryshme;
3. Të shërbejë si hapësirë për ndërlidhjet njerëzore dhe shkëmbimin e historive frymëzuese të shqiptarëve në mbarë botën; Të shërbejë si platformë për rrjetëzim dhe shkëmbim;
4. Forcimi i lidhjeve kulturore dhe identitare mes të diasporës dhe vendeve amë.



Konferenca e fundit e Germin «Diaspora Flet» e zhvilluar në Prishtinë.

**Pjesëmarrësit:** GERMIN synon të ketë mbi 400 pjesëmarrës të konferencës, duke përfshirë përfaqësues të sektorit të biznesit, profesionistë dhe ekspertë nga diaspora, individë të suksesshëm dhe me ndikim në komunitet, përfaqësues të institucioneve vendore, shoqëria civile, si dhe

organizata partnere lokale dhe ndërkom-bëtare nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova lindore (Presheva, Medvegja dhe Bujanovci) dhe Mali i Zi.

Për më shumë informata në internet: <https://bit.ly/40ylkyX>